



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1174/2 Prot.

Tiranë, më 16.07. 2019

### V E N D I M

**Nr. 81, datë 16.07.2019**

#### **PËR RREGULLIMIN E GJENDJES SË LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME AKTIN NR.137, DATË 1.7.2019, TË KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL, PËR LARGIMIN NGA SHËRBIMI CIVIL TË NËPUNËSES \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

#### **VËREJ SE :**

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 1174 prot., datë 2.7.2019, nga Task-Forca për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2019, Komisioneri mori dijeni se, për arsye të lidhura me procesin zgjedhor, punonjësja \*\*\*\*\* nëpunëse civile pranë Bashkisë Devoll, është larguar nga detyra, pa respektuar rregullat e përcaktuara në legjisllacionin e shërbimit civil.

Në këto kushte, Task-Forca, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, që në kuadrin e kompetencës së tij për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, të verifikojë, të vlerësojë dhe të ndërhyjë për zgjidhjen e rastit në fjalë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Duke u nisur nga sa më sipër, gjatë këtij hetimi administrativ, Komisioneri, administroi të dhëna nga Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes të kryer pranë Bashkisë Devoll, si dhe materiale

të administruara nëpërmjet shkresës zyrtare me nr. 2199/1 prot., datë 5.7.2019, “*Kthim përgjigje*”, e Kryetarit të Bashkisë Devoll, në lidhje me rastin e punonjësës \*\*\*\*\*.

Nga përmbajtja e akteve të administruara në dosjen e personelit, gjatë procesit të mbikëqyrjes të kryer nga Komisioneri pranë këtij institucioni, rezulton se, punonjësja \*\*\*\*\* ka kryer detyrën Administratore e Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Miras, pranë Bashkisë Devoll, e emëruar sipas procedurave të konkurrimit, parashikuar në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar (akti nr.971, datë 8.6.2017) dhe e konfirmuar nëpunës civil në këtë pozicion (akti nr.177/2, datë 18.8.2018).

Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, ka lindur për shkak se, Kryetari i Bashkisë Devoll, meurdhrin nr. 137, datë 1.7.2019, ka vendosur largimin i saj nga detyra si Administratore e Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Miras dhe ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve financiare, me motivacionin se ajo ka shkelur nenin 37, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer për verifikimin e këtij rasti, konstatohet se, sipas një relacioni të mbajtur në datën 28.06.2019 nga grupi i monitorimit ngritur pranë Bashkisë Devoll, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, pas kryerjes së një kontrolli për praninë e nëpunësve të bashkisë gjatë orarit të punës, pretendohet që punonjësja \*\*\*\*\* nuk është gjendur në vendin e punës, por ka qenë duke marrë pjesë në fushatën elektorale, në mbështetje të një kandidati të një force politike, për zgjedhjet vendore 2019.

Kjo sjellje e saj, është vlerësuar se bie ndesh me parimin e paanësisë politike të sjelljes së nëpunësit civil dhe vjen në kundërshtim me rekomandimet që ka dhënë Komisioneri në fillim të fushatës zgjedhore, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e nenit 37, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në pikën 1, të të cilit thuhet: “*Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar dhe nuk duhet të shprehë hapur bindjet apo preferencat e tij politike*” e mbi këtë bazë, drejtuesi i institucionit, duke e konsideruar veprimin si thyerje të rëndë të disiplinës në punë, ka vendosur largimin e menjëhershëm nga detyra të punonjësës \*\*\*\*\*.

Në vijim të procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së këtij akti, konstatohet se, në nxjerrjen e tij, nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në legjisllacionin e shërbimit civil, gjë e cila bën që akti administrativ i nxjerrë në këtë rast, për largimin nga puna të punonjësës në fjalë, të humbasë vlefshmërinë si i tillë.

Në kushtet kur punonjësja \*\*\*\*\* është nëpunëse civile, legjisllacioni i shërbimit civil, parashikon një procedurë të hollësishme dhe të detyrueshme, e cila ka për qëllim

garantimin e qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës në shërbimin civil dhe garanton të drejtën e mbrojtjes së nëpunësve civilë nga një arbitraritet i mundshëm administrativ.

Procedura e detyrueshme, që duhet ndjekur në dhënien e një mase disiplinore është e parashikuara në mënyrë të hollësishme në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në rastin konkret, duke qenë se shkelja disiplinore është konstatuar nga grupi i monitorimit, sipas nenit 57, pika 3, shkronja “ë”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, klasifikohet si shkelje e rëndë, procedimi disiplinor, në bazë të pikës 2, të nenit 59, të këtij ligji, duhet të kryhet nga Komisioni i Disiplinës, i cili duhet të vihet në lëvizje nga grupi i monitorimit ose drejtuesi i institucionit, sipas pikës 4, shkronja “b”, të nenit 59, të ligjit, e cila përcakton se, “Komisioni disiplinor fillon procedimin: b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ...”.

Trajtimi i këtij rasti drejtpërdrejt nga Kryetari i Bashkisë, përbën një shkelje të kompetencës në nxjerrjen e aktit, gjë e cila në kuptim të pikës a/i, të nenit 108, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, e bën këtë akt absolutisht të pavlefshëm.

Nga ana tjetër, në kushtet e një zbatimi të drejtë të ligjit, Komisioni i Disiplinës, përbërja e të cilit është e parashikuar në pikën 3, të Kreut I, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, pasi të administrojë kërkesën e grupit të monitorimit, duhet të fillojë ecurinë disiplinore, duke respektuar procedurat e parashikuara në pikën 13, të këtij vendimi, të cilat i garantojnë nëpunësit të drejtën për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit; për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për vërtetimin e saj, shpalljen e të drejtës për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike, datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar, etj.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, në të cilën nëpunësi ka të drejtë të parashtojë argumentat dhe provat e tij që kundërshtojnë këtë ecuri disiplinore, në përfundim të këtij procesi administrativ, Komisioni i Disiplinës, merr vendimin përfundimtar duke arsyetuar dhe shpjeguar faktet që janë bazë e arsyetimit të tij, për marrjen e vendimit.

Nga përmbajtja e materialeve të administruara, në rastin konkret, nuk rezulton të jetë ndjekur kjo procedurë, gjë e cila pohohet në mënyrë të shprehur edhe në shkresën kthim përgjigje dërguar Komisionerit nga Bashkia Devoll, nënshkruar nga titullari i institucionit, ku nënvizohet se, “...në rastin e punonjësës \*\*\*\*\*, nuk është ndjekur asnjë procedurë, përveç faktit që u mbajt një relacion nga grupi i mbikëqyrjes për monitorimin e shërbimit civil...”.

Nga gjithë sa analizuam më sipër, arrihet në përfundimin se, akti nr. 137, datë 1.7.2019, i Kryetarit të Bashkisë, për largimin nga detyra të punonjësës \*\*\*\*\*, ka dalë në kundërshtim me kompetencën dhe procedurën e kërkuar nga ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në këto kushte, në vështrim të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, i cili, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, nuk sjell asnjë pasojë juridike, e për rrjedhojë, në bazë të neneve 110, pika 2, 111 dhe 113, të po këtij ligji, vetë organi publik, në këtë rast, Kryetari i Bashkisë, që ka nxjerrë aktin, duhet të anulojë këtë akt duke urdhëruar edhe rregullimin e pasojave.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në nenet 108 pika ii), 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, drejtuesi i institucionit të Bashkisë Devoll, që të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr.137, datë 1.7.2019, për largimin nga detyra të nëpunësës \*\*\*\*\*, dhe ta anulojë atë, duke urdhëruar kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës, si Administratore e Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Miras, pranë Bashkisë Devoll.
2. Pas kryerjes së këtij veprimi, grupi i monitorimit që ka përpiluar relacionin e datës 28.6.2019, ku evidentohet shkelja e pretenduar se është kryer nga punonjësja \*\*\*\*\*, të kërkojë nisjen e ecurisë disiplinore, duke e prezantuar rastin para Komisionit të Disiplinës, sipas rregullave që u përmendën në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

3. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Devoll dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10** ditë.
5. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**